

Thirrje për aplikim: Organizata Germin fton gratë ndërmarrëse në Kosovë, bizneset e të cilave kanë potencial për eksport që të përfitojnë nga programi i mentorimit për një periudhë shtatë (7) mujore nga profesionistët e diasporës.

### Përmbledhje e projektit

Organizata Germin me përkrahje të ‘USAID Kosovo Compete Activity’ është duke implementuar projektin **“Diaspora për Gratë Ndërmarrëse”**. Qëllimi kryesor i projektit është të lehtësojë lidhjen e bizneseve në pronësi dhe/ose të menaxhuara nga gratë në Kosovë, me bizneset dhe profesionistët/et në diasporë, me qëllim të përsheptimit të rritjes së bizneseve të udhëhequra nga gratë në Kosovë përmes mentorimit dhe rrjetëzimit me profesionistë/e të Diasporës. Një nga problemet kryesore që ndërhyrja synon të adresojë është rritja e kufizuar e bizneseve në pronësi të grave në Kosovë për shkak të mungesës së qasjes në tregjet e huaja, veçanërisht të bizneseve me kapacitete për eksport. Në muajin Prill të këtij viti ka filluar kohorta e parë e mentorimit për 20 gra ndërmarrëse nga Kosova të cilat po mentorohen të ndara në grupe nga 10 mentorë nga Diaspora.

Edhe në kohortën e dytë Germin do të përzgjedhë 10 profesionistë/e nga Diaspora, të cilët për një periudhë shtatë (7) mujore do të angazhohen si mentorë/e për mbi 20 gra ndërmarrëse në Kosovë, me synimin që këto të fundit të ngritin njohuritë dhe shkathtësitë në të bërit biznes si dhe të gjejnë mundësi për të depërtuar në tregje të huaja përmes rrjeteve të diasporës. Sektorët e preferuar të bizneseve të grave ndërmarrëse nga Kosova për t’u bërë pjesë e këtij programi janë: Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK); Prodhimi apo përpunimi i Ushqimit; dhe Përpunimi i Drurit.

### Përfitimet kryesore për gratë ndërmarrëse nga programi i mentorimit

Gjatë periudhës së mentorimit gratë ndërmarrëse në Kosovë ndër të tjerat mund do të përfitojnë njohuri shtesë rreth:

- Teknikave të menaxhimit më të mirë të biznesit;
- Menaxhimit financiar më stabil;
- Metodave të rritjes së burimeve financiare dhe njerëzore;
- Qasjes në tregjet e huaja jashtë Kosovës – fillimi i eksportit të produkteve;
- Përgatitjes dhe organizimit të takimeve Biznesi me Biznesin (B2B) dhe Biznesi me Klientin (B2C);
- Procedurat e monitorimit dhe vlerësimit të punës së biznesit;
- Rrjetëzimit me kompani të tjera të profilit të ngjashëm brenda dhe jashtë Kosovës;
- Brendimi dhe ambalazhimi i produkteve apo shërbimeve;
- Prezenca dixhitale dhe përdorimi i mediave sociale, etj.

Po ashtu gratë ndërmarrëse të cilat do të jenë pjesë e programit të mentorimit do të kenë mundësi të jenë pjesë e një panairi virtual të dedikuara vetëm për to. Ndërsa 10 gratë më aktive gjatë programit dhe me më së shumti potencial për eksport do të jenë pjesë e një takimi në Diasporë me qëllim të takimeve me biznese të tjera.



### Përgjegjësitë e grave ndërmarrëse përfituese të programit të mentorimit

Padyshim që programi i mentorimit për gratë ndërmarrëse do të shërbej në përfitim të njohurive të reja, ide për rritje të biznesit, stabilitet, rritje të resurseve humane si dhe fillim/rritje të eksportit. Gjatë periudhës shtatë mujore sa do të zgjas programi i mentorimit gratë ndërmarrëse duhet të jenë aktive në pikat në vijim:

- Të tregojnë se janë të gatshëm për bashkëpunim dhe kanë interes të përfitojnë nga programi i mentorimit
- Të jenë pjesë e çdo sesi virtual
- Të mbajnë takime të vazhdueshme me hisedarë për mundësitë e rrjetëzimit dhe fillimit të eksportit për produktet e tyre.
- Të promovojnë në rrjete sociale dhe emisione televizive përvojën e mentorimit dhe sukseset që do të kenë gjatë periudhës shtatë mujore në biznesin e tyre.

### Si të bëheni pjesë e programit të mentorimit?

Të gjitha gratë ndërmarrëse të cilat kanë interes të përfitojnë nga programi shtatë mujor i mentorimit duhet të përmbushin kriteret në vijim:

- Të jenë të regjistruara në ATK
- Të posedojnë numër fiskal
- Të mos kenë borxhe në ATK
- Të jenë biznese me potencial për eksport

Afati i fundit për aplikim

9 shtator 2022

Për të aplikuar, klikoni [KËTU](#)